VENDIM
Nr.945, datë 26.8.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS PISHAJ TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pishaj, të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Pishaj të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.1645, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Pishaj, të qarkut të Elbasanit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Pishaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Pishaj Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-3	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
10-33	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
34,36-40	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
42-45	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
46,47,50	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
51-59,62-70	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
79-111	Varrezat publike	Në pronësi
246-270,273-303,305-376,378-382,384-396,399-404,406-407,409	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
410-422,424-440,442,443,445-474,478,480-500,502-514,516-519	Infrastrukturë (rrugë vendore).	Në pronësi
564,565,569-571,575-577,582-584,588-591,594-597,601,605-	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të	Në përdorim

607,611-613,617-619,623-626, 631,635,641-649,653-659	ushqimit (toka produktive).	
566-568,572-574,578-581,585-587,592-593,598-600,602-604, 608-610,614-616,620-622,627-630,632-634,636-640,650-652, 660-662,663-762 (vetëm kanalet e III)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
1088	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi